

Nr. _____ prot.

Urë Vajgurore, më _____._____.2025

**PROCES-VERBAL I ARGUMENTIMIT DHE MIRATIMIT TE SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Tipi i kontratës-Shërbim

OBJEKTI I PROKURIMIT: Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Dimal

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontrates : **127,318,776 (njëqind e njëzet e shtatë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë.

Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë: Procedurë e hapur- shërbim, Marëveshje kuadër

Arsyeja e përdorimit të procedurës – Procedur e hapur, mbi kufirin e lartë monetar pasi vlera e fondit limit është më e lartë se kufiri i lartë monetar.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 90910000-9 - Shërbime të pastrimit

Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal (Njesia e prokurimit) ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet me qëllim vlerësimin e situatës ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë dhe rrjedhimisht të disponimit të kapaciteteve ekonomike dhe financiare për të realizuar me sukses kontratën dhe është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43, pika 2, germa "b" të VKM nr.285 datë 19.05.2021.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021 ,2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” dhe nenit 29, pika 1, të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 1.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: i) faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjithë zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; ii) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet me qëllim vlerësimit të përvojës së mëparshme të operatorit ekonomik në shërbimet objekt kontrate dhe është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 41, pika 3 të VKM nr.285 datë 19.05.2021

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit, i cili duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë (sipas përcaktimeve të VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të perbashkëta).

Për	drejtuesin	Teknik	të	kërkuar	të	paraqitet:
a)						Diplomë
b)		CV				përkatëse
c)	Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).					

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi : Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe shërbimi do të kryhet brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me Leje III.B, si më poshtë, të shoqëruara me akt miratimin përkatës.

- Kategoria III.1.B “Për ndikimin në Mjedis”, larje dhe pastrim mjetesesh motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme.

- Kategoria III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 8 dhe 9 të VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar,

2.3.4 Operatori ekonomik, për kryerjen e shërbimit të pastrimit objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar mesatarisht 25 (njëzet e pesë) punonjës, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisit ose 1 (një) (Ekspert në fushën e Mjedisit)
- 2 (dy) Manovrator
- 7 (shtatë) Shofer
- 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës shërbimi

Per të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet të paraqesin:

- Inxhinieri i Mjedisit/eksperti: Kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.
- Shoferët: Kontratë pune e vlefshme, leje drejtimi, certifikate e aftësie profesionale.
- Manovratorë: Kontratë pune e vlefshme, leje drejtimi, deshmi e aftësie profesionale.
- Gjithashtu për përmbushjen e këtij kriteri, të gjithë punonjësit e mesipër duhet të figurojnë në

listpagesën e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit dhe të paraqesin:

- Vërtetim per Kontributet e Sigurimeve Shoqerore e Shendetesore per Tatimpaguesin, të lëshuar nga Administrata Tatimore,
- Listepagesat e kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi.

Shënim: Në rastin kur punonjësit shofere janë te kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e permblusur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi : Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 25 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 48 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë certifikatat ISO, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001-2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001 -2023 Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Pune

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mesipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi : *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose entikontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/entikontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

1-Certifikat: ISO 9001:2015 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te shërbimit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

2- Çertifikimi i Sistemit për Menaxhimin te mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te shërbimit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

3-Certifikat: ISO 45001:2023, - Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Pune Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te shërbimit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

1 (një) punonjës me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në pune” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Shoqëruar me kontratë individuale punë të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Disponimi i punonjësit “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të kontraktimit të një punonjësi të pajisur me

certifikatën si “Pergjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, kontrata duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës së shërbimit.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi : AK argumenton se kërkesa për 1 (një) *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me shërbimin e pastrimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së pastrimit. Për sa më lart, punonjësit të cilët janë të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë shërbimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si më poshtë:

- a. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 10 deri në 12 ton, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi);
- b. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 4-6 ton, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi);
- c. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi);
- d. Makina për larjen e rrugëve, (autobot), me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi);
- e. Kamioncine me kapacitet transportues 1 deri në 3.5 ton, për transportimin koshave të vegjël etj, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi);
- g. Kamion Veteshkarkues me kapacitet transportues mbi 3.5 ton, për transportimin e inerteve dhe kontenierëve, pa sjellë demtimin e tyre, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

h. Fshese automatike e pajisur me sistem thithës/fryrës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

i. Eskavator për pastrimin, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

j. Fadrome për ngarkimin e inerteve, mbeturinave, dherave etj, jo më pak se 1 (një) copë (në pronësi / me qira / porosi).

Për Mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit, certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit. Për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të shërbimit.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, si dhe dokumenti me të dhënat teknike të mjetit.

Për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të shërbimit.

- Në rast se mjetet nuk janë në pronësi apo me qera mund të paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontrate Porosie. Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (original ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur (emërtimin teknik), llojin, markën, nr. e shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku lejon AK të verifikojë mjetet dhe pajisjet para shpalljes së fituesit dhe gjatë zbatimit të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se dissonojnë mjetet e nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

*

Specifikimet teknike bashkëlidhur dhe pjesë e DST janë hartuar nga Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknik, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
- **Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga anëtarët specialistë të Njesisë së Prokurimit.**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

Mateo Plaku

Marije Bizdani

Gerald Bolani